



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
Centralna Izborna Komisija
Central Election Commission



Në bazë të autorizimeve të dhëna me nenin 10.3 të Ligjit nr. 03/L-072 për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës, nenin 37 paragrafi 2, nën paragrafi (c), nenin 65.2 të Ligjit nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, si dhe nenin 6, dhe 7 të Udhëzimit Administrativ nr.01/2017, për Procedurën e Zëvendësimit të Anëtarit të Anëtarit të Kuvendit Komunal, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, më 12.11.2019, nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. **Z.ARBEN LIMANAJ** emërohet anëtar i Kuvendit Komunal në Klinë, nga subjekti politik "Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK)" duke e zëvendësuar anëtarin e Kuvendit Komunal z. Enver Gashi.
- II. Obligohet Sekretariati i KQZ-së, që ky vendim t'i komunikohet z. Arben Limanaj, dhe të ndërmerren veprimet procedurale për zbatimin e tij.

Arsyetim

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve pas shqyrtimit të shkresave të lëndës të dorëzuara në KQZ më datën 11.11.2019, Nr.1732/2019, për zëvendësimin e anëtarit të Kuvendit z.Enver Gashi, pas dorëheqjes së tij të parevokueshme nga pozita e anëtarit të Kuvendit të Komunës për arsye të emërimit në pozitën Drejtor i Drejtorisë Komunale të Arsimit.

Andaj, duke u bazuar në deklaratën e pranimit të mandatit të kandidatit të radhës sipas listës së rirenditur, i cili është, z.Arben Limanaj nga i njëjti subjekt politik, i gjinisë së njëjtë dhe me numër më të madh të votave, sipas rezultateve të certifikuar të zgjedhjeve lokale të vitit 2017, dhe pas plotësimit të të gjitha kushteve ligjore, KQZ-ja vendosi si në pikën I të këtij vendimi.

- III. Ky vendim, hyn në fuqi ditën e nënshkrimit të tij.

Prishtinë, 12.11.2019

Kryetare e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve

Republika e Kosovës
Republika Kosova
Prishtinë
Prishtina
KOMISIONI QENDRORE I ZGJEDHJEVE
Valdete Daka